



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 24 Regj.Them.

Nr. 24 VENDIMI

Datë 22.05.2023 Regj.Them

Datë 24.05.2023 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Emona MUÇI	<i>(Relatore)</i>
Gjyqtare:	Alma KOLGJOKA	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Esmeralda XHILI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Marsela DERVISHI	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtar:	Sokol IBI	<i>(Anëtar)</i>

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë **24.05.2023**, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. **24** akti, datë **22.05.2023** që i përket:

PADITËS: **Safet Gjici**, i datëlindjes 1972, lindur ne Kukës, kryetar i bashkisë Kukës dhe kandidat për kryetar të bashkisë Kukës, në mungesë.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr. 5385 Prot., datë 23.05.2023 nga Znj.Ina Osmanaj.

PALË E INTERESUAR: **Qendra “Qëndresa Qytetare”**, përfaqësuar në gjykim me autorizim datë 23.05.2023 nga z. Rigels Xhemollari

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 85, datë 08.05.2023 të KAS për pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 19 dhe nr. 20, të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Vendimi nr.

17/2016, i Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen. emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

në seancën e datës **24.05.2023**, ,asi verifikoi paraqitjen e palëve, konstatoi mungesën e palës paditëse dhe pasi dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur, e cila kërkoi pushimin e gjyqimit të çështjes,

VËREN:

1. Se pala paditëse, z. Safet Gjici kandidat për kryetar Bashkie Kukës subjektin zgjedhor **Partia Socialiste e Shqipërisë** i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Shfuqizimi i vendimit nr. 85, datë 08.05.2023 të KAS për pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 19 dhe nr. 20, të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve*”.
2. Nga aktet e dosjes rezulton se më datë 22.05.2023 pala paditëse ka paraqitur kërkesë padinë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nëpërmjet shërbimit postar (njoftuar me datë 17.05.2023 vendimi i KAS, dorëzuar në postë më datë 19.05.2023), brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.
3. Kërkesë padia rezulton të jetë paraqitur me të meta procedurale në hartimin e saj dhe me vendim datë 22.05.2023 gjykata në respektim të në nenit 154/3 të Kodit Zgjedhor i la afat palës paditëse për plotësimin e plotë të formës dhe të paraqitjes së saj,
4. Në seancën e datës 24.05.2023 kërkesë padia rezulton të jetë paraqitur në në formën e duhur procedurale, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 153 të Kodit Zgjedhor.
5. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.
6. Në seancën gjyqësore të datës 24.05.2023, pala paditëse nuk u paraqit. Kolegji Zgjedhor hetoi në lidhje me shkaqet e mosparaqitjes dhe konstatoi se pala paditëse kishte marrë dijeni për datën dhe orën e seancës dhe pa shkaqe të justifikuara nuk ishte paraqitur. Pala e paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në seancën

gjyqësore në datë 24.05.2023, nëpërmjet përfaqësueses të saj, pasi është vënë në dijeni të faktit se paditësi Safet Gjici nuk është paraqitur në seancë pa shkaqe të justifikuara, ka kërkuar pushimin e gjykimit, pasi paditësi nuk ka interes.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

7. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.13864 datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
8. Pala paditëse/ Safet Gjici është kryetari i bashkisë Kukës, njëkohësisht kandidat për kryetar në bashkinë Kukës për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
9. Pala e paditur/Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, është institucioni shtetëror i ngarkuar për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e vendosura në Kodin Zgjedhor.
10. Pala paditëse/ Safet Gjici kryetari i bashkisë Kukës është denoncuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Qendra “Qëndresa Qytetare” (denoncime nr. 335 ID dhe nr. 336 ID) duke pretenduar se ka patur përdorim të burimeve publike nga ana z. Safet Gjici kryetari aktual i bashkisë Kukës dhe kandidat për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.
11. Me kërkesën nr. 19 dhe nr. 20, datë 06.05.2023, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i është kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) vendosja e sanksionit administrativ me gjobë, për shkelje të dispozitave të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, mes të cilëve edhe për paditësin si vijon: *“... kryetari i bashkisë Kukës, njëkohësisht kandidat për kryetar në bashkinë Kukës, me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi” ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, vlerësoj se jemi në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, për drejtorin e shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi” fashti Fshat, Kukës, z. Betim Lushi, pasi ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie, ambientet e shkollës për qëllime zgjedhore. Rezultoi e provuar se ambientet e jashtme të shkollës janë të rrethuara..”*.
12. Në përfundim të shqyrtimit të denoncimeve të paraqitura nga Qendra “Qëndresa Qytetare”, Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1,

- shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91, 92 ,171, pikat 1 dhe 2, të Kodi Zgjedhor , vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 439 datë 05.05.2023 propozoi, më poshtë: ... “ *T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për: a) z. Safet Gjici, Kryetar dhe njëkohësisht kandidatit për bashkinë Kukës në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.*
13. Gjithashtu Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, mbi denoncimin e bërë nga Qendra “Qëndresa Qytetare” për paditësin Safet Gjici, me vendimin nr. 440 datë 05.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 336 ID të organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj kryetarit të bashkisë Kukës, drejtorit të përgjithshëm të agjencisë shtetërore të kadastrës, drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati” Kukës dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023” propozoi, më poshtë: ... “ *T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për: a) z. Safet Gjici, Kryetar dhe njëkohësisht kandidatit për bashkinë Kukës në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.*
 14. Komisioneri i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesën nr. 19, dhe 20 datë 06.05.2023 për vendosje sanksioni administrativ për shkeljet e konstatuara nga paditësi Safet Gjici për zgjedhjet organeve të qeverisjes vendore, datë 14.05.2023 ku është edhe paditësi.
 15. Në seancën e datës 08.05.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 79, vendosi shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 19 dhe nr. 20 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në datën 08.05.2023.
 16. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendim nr. 85, datë 08.05.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 19 dhe nr. 20, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, ka vendosur: “*1. Pranimin e pjesshëm të kërkesave të Komisionerit dhe palës së interesuar. 2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës, sipas nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë. 3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Dallëndyshe Bici,z. Rustem Dervishi dhe z. Betim Lushi, sipas nenit 171, pika 2 të Kodit Zgjedhor, gjobë në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për pikën 2 të dispozitivit, bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij. Për pikën 3 të dispozitivit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, të ndryshuar”.*

17. Ky vendim është kusndërshtuar nga paditësi Safet Gjicipranë Kolegjit Zgjedhor, duke paraqitur padinë me objekt dhe bazë ligjore të pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit.

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:

18. Kolegji pasi verifikoi paraqitjen e palëve, dëgjoi përfaqesën e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, si dhe analizoi dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin konkret, vlerëson se padia me paditës Safet Gjici duhet të pushohet. Në arritjen e këtij përfundimi Kolegji zgjadhur referon në dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Kodit të Procedurës Civile që dispijlojnë vendimarrjen e Kolegjit në rastet e mosparaqitjes së palëve.

19. Konkretisht, neni 156 ‘Të drejtat e palëve në procesi’¹, i Kodit Zgjedhor parashikon se:

1. *Palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadiisë kanë të gjitha të drejtat procedurale, që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.*

2. ...

3. *Mungesa e njëres palë gjatë procesit nuk përbën pengesë për vazhdimin e gjykimit nga ana e Kolegjit Zgjedhor, **përveç rastit kur kolegji vendos ndryshe.***

19.1 Nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Civile në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka efekt plotësues përsa në nenin 156 të tij përmbahet ky parashikim ligjor: “*Palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadiisë kanë të gjitha të drejtat procedurale, që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod*”.

20. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor referon në përmbajtjen e nenit 179 të K.pr.Civile, në të cilin parashikohen pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve. Në këtë dispozitë ligjore parashikohet se: “*Nëse asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit. 2. Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit*”.

21. Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson plotësohen kushtet ligjore për pushimin e gjykimit të çështjes. Në rastin konkret, paditësi nuk është paraqitur në gjykim pa shkaqe të justifikuara, duke reflektuar mungesë interesi për

¹ Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012

gjykimin. Nga ana tjetër, pala e paditur nuk ka kërkuar vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit, si një nga rastet e parashikuara nga neni 179/2 i K.Pr.Civile, por ka kërkuar në mënyrë të shprehur pushimin e gjykimit.

22. Në nenin 179 të K.Pr. Civile është përcaktuar qartë se në rastet e mosparaqitjes së paditësit pa shkak të arsyeshëm, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Kjo zgjidhje nuk cenon asnjë të drejtë të të paditurit, pasi gjykata investohet mbi kërkimin e paditësit, të cilit i përket e drejta e disponimit të padisë (e iniciativës së palës). Të drejtat kushtetuese si: e drejta e aksesit, e drejta për t'u dëgjuar apo e drejta për dhënien e një vendim përfundimtar për çështjen, janë të kushtëzuara nga e drejta e disponimit të padisë. Për rrjedhojë, mosparaqitja e paditësit në gjykim lidhet me reflektimin e mungesës së interesit të tij për vijimin e gjykimit. Nga ana tjetër, Kolegji Zgjedhor, duke vlerësuar në tërësi objektin dhe shkakun ligjor të padisë objekt gjykimi, interesin që pretendohet se është cënuar si dhe sjelljen e paditësit në raport me procesin gjyqësor të iniciuar prej tij, vlerëson që të mos vijojë gjykimin në mungesë të paditësit, por të zbatojë përjashtimin nga ky rregull, duke aplikuar pasojat e parashikuara nga neni 179 i K.Pr.Civile, i cili gjen zbatim edhe në procedurat gjyqësore që zhvillohen nga Kolegji Zgjedhor, referuar parashikimit të nenit 153 të Kodit Zgjedhor.
23. Në sintezë të analizës së mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se në çështje objekt gjykimi konstatohet mungesa e interesit të palës paditëse për të vijuar gjykimin. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor, vlerëson se gjykimi i padisë duhet të pushohet dhe si e tillë, nuk mund të merret në shqyrtim në themel nga ky Kolegj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar, dhe nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes nr.24 Regj. Themeltar, datë 22.05.2023.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim

U shpall sot në Tiranë, në datë 24.05.2023.

GJYQTARE	GJYQTAR	GJYQTARE	GJYQTARE	GJYQTARE
Alma KOLGJOKA	Sokol IBI	Marsela DERVISHI	Esmeralda XHILI	Emona MUÇI

Pjesërisht kundër